



Qeveria e Republikës së Maqedonisë -
Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

në bashkëpunim me
Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave – Trupi drejtues me IPARD

publikojnë

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2010

Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2007-2013

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencionit për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2007, 05/2009) dhe në pajtueshmëri me Programin për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë para-pranuese për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 83/2009), shpallet thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2007-2013 për masat në vijim:

- Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritje të standardeve të Unionit Evropian ku të pranueshme janë ato projekte që shuma e përgjithshme për harxhime të pranueshme është minimum 5,000 euro (308.025,00 denarë në kundërvlerë të denarit) dhe maksimum 400.000 euro, (24.642.000,00 denarë në kundërvlerë të denarit),
- Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit Evropian ku projekte të pranueshme janë ato të cilat shuma e përgjithshme e tyre për harxhime të pranueshme është prej 15.000 euro (924.075,00 denarë në kundërvlerë të denarit) dhe maksimum 800.000 euro, (49.284.000,00 denarë në kundërvlerë të denarit) me përjashtim të investimeve për vendosje të kapaciteteve të thertoreve për kafshët ku projekte të pranueshme janë ato projekte që shuma e përgjithshme për harxhime të pranueshme mund të arrijnë maksimum 3.000.000 euro (184.815.000,00 denarë në kundërvlerë të denarit), dhe
- Masa 302 – Diverzifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale ku projekte të pranueshme janë ato të cilat shuma e përgjithshme e tyre për harxhime të pranueshme është minimum 5.000 euro (308.025,00 denarë në kundërvlerë të denarit) dhe maksimum 200.000 euro (12.321.000,00 denarë në kundërvlerë të denarit).

Për masën 101 dhe masën 103 kërkesë mund të dorëzojnë persona ligjor dhe fizik për investime të vendosura në teritorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa për masën 302 kërkesë mund të dorëzojnë persona ligjor dhe fizik për investime që gjenden në hapësira rurale.

Buxheti i paraparë indikativ për këtë Thirrje publike është gjithsej 40.028.365,00 euro, (2.465.947.426,00 denarë në kundërvlerë të denarit), prej të cilave 75% të mjeteve janë të siguruara nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë gjatë para-pranimit për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) dhe 25% të mjeteve janë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesës, duke përfshirë edhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 mund të merren në web faqen www.ipardpa.gov.mk, si dhe personalisht në recepcionin e Agjencionit për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe në qendrat regjionale më të afërta ose njësitë punuese të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej orës 8:30 deri më 16:30.

Kërkesat për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 me dokumentacionin e duhur dorëzohen detyrimisht me zarf të mbyllur me shënim në anën e parme të zarfit në këndin e majtë lartë "MOS E HAP" për Thirrje publike IPARD numër 01/2010 dhe shënimin e kodit të masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës në adresën: "Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural", rr. Skupi nr. 3-a, (ndërtesa Fonko), 1000 Shkup si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në recepcionin e Agjencionit për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, çdo ditë pune nga dita e publikimit të kësaj shpallje deri në datën e afatit përfundimtar për dorëzimin e kërkesave. Shënim: Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 dhe dorëzimi i dokumentacionit të shoqëruar NUK KTHEHEN. Për kryerjen e kontrollës në teren kërkuesi duhet të mban kopje të dokumentacionit të përgjithshëm të dorëzuar deri te Agjencioni.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 29.11.2010, viti.

Kontaktet për informata më të detajuara:

Tel: 02 3097-460

Fax: 02 3097-454

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



**Instrument për ndihmë parahyrese të Bashkimit Evropian
për zhvillim rural për 2007-2013**

